



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 30 dhjetor 2015, në mbledhjen e XXIV-të (njëzetekatër) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Mirsad Kamerolli dhe z.Rafet Llapashtica të cilët munguan.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Agim Veliu Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera shtoi, konsideroj se rendi i propozuar i ditës dhe materiali përkatës u është dërguar me kohë, po ashtu rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa u janë dhënë në hyrje të kësaj mbledhjeje. Para se të fillojmë me rendin e ditës, pyes a dëshiron ndokush të marrë fjalën.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, dua të bëjë një deklaram, sot kur Republika e Kosovës është duke u përballur me një krizë politike për herë të parë që nga paslufta, por jo krizë qeveritare, ndjejë përgjegjësi para së gjithave përgjegjësi para qytetarëve të Komunës së Podujevës e veçanërisht atyre që më kanë votuar, që kontributin dhe angazhimin tim politik tash e tutje do të jap në kuadër të Grupit të këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës dhe në përgjithësi kontributin tim tash e tutje do të jap në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës si alternativën e vetme racionale në skenën politike të Republikës së Kosovës. Qëndrimi im sot mendoj se pasqyron edhe mendimin qytetarë jo vetëm në Komunën e Podujevës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, parafolëses i dëshiroj suksese në punë dhe në dhënien e kontributit në kuadër të subjektit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

z.Haki Rudari, theksoi, mendoj se me qëllim apo pa qëllim po ndodhë të devijohen disa gjëra, dhe në radhë të parë unë propozoj që në të ardhmen në kuadër të rendit të ditës përkatësisht pas miratimit të rendit të ditës, në pikën 2 të jetë një pikë rreth rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa për arsye se në atë Komitet jemi vetëm 10 anëtarë dhe të tjerët nuk janë. Çështja tjetër të cilën dua të ngrisë është se në rekomandimet e KPF-së që i morëm në hyrje të kësaj mbledhjeje, dëshiroj të jap një sqarim, dje Komiteti për Politikë dhe Financa ka marrë një vendim, e që besoj se nuk ka të drejtë që KPF të merr vendime, vendim për shpërndarjen e 450 metra dru, unë e kam lexuar Rregulloren në të cilën kompetencat e këtij Komiteti janë të sqaruara shumë mirë ku KPF ka të drejtë të merr në përgjegjësi për shqyrtim të gjitha politikat, përcjellë punën e Ekzekutivit të Komunës dhe shqyrton dhe jep rekomandime lidhur me çështjet dhe materialet të cilat i propozohen Kuvendit për shqyrtim, andaj asnjëherë KPF në bazë të Rregullores nuk ka të drejtë të merr vendime. Sa i përket çështjes rreth shpërndarjes së druve, unë dje në mbledhjen e KPF-së në parim e kam përkrahur por kam qenë kundër asaj se mos eventualisht bëjmë shkelje të Rregullores dhe Ligjit, dhe po ashtu kam qenë kundër që shpërndarja e druve të bëhet shkollave për arsye se sipas drejtorit furnizimi me lëndë djegëse për shkolla ka mjetet e veta dhe është dhënë tenderi, andaj shtroj pyetje përse t'iu jepen dy herë shkollave lënë djegëse. Vërejtje tjetër e imja ka qenë se është bërë një shkelje e Rregullores së Komitetit për arsye se Komiteti për Politikë dhe Financa nuk ka të drejtë të merr vendime por vetëm shqyrton dhe jep rekomandime.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, fillimisht rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa u janë shpërndarë të gjithëve në hyrje dhe besoj se të gjithë i posedoni, ndërsa sa i përket çështjes të cilën e potencoj parafolësi, e vërteta është se ne në atë mbledhje i kemi shqyrtuar kërkesat e tri Drejtorive të Komunës përkatësisht Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe meqë jemi në dimër dhe gjendja e familjeve në asistencë sociale është shumë e rëndë, kurse drutë janë grumbulluar nga konfiskimet për shkak të prerjeve ilegale dhe nëse ato dru qëndrojnë edhe për një kohë në atë gjendje sigurisht se do të prishen për shkak të reshjeve, kështu që ne në mbledhjen e KPF-së kemi shqyrtuar një rekomandim, por që nuk ka qenë rekomandim për Kuvend, për shkak se nëse vazhdojmë më tutje do të përmirësohet koha dhe nuk do të mund t'i ndihmojmë askujt, po ashtu kanë qenë kërkesa që t'iu ndihmojmë disa shkollave të cilat kanë mungesë të druve. Pra kjo çështje nuk ka kaluar në Kuvend për shkak se është urgjente, por e vetëm kemi dhënë një rekomandim, andaj konsideroj se gjithçka është e qartë dhe nuk mendoj se ka ndonjë problem.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, lidhur me çështjen e ngritur rreth shpërndarjes së druve për rastet e rënda sociale, unë ditë më parë rastësisht kam hyrë në zyrën e Kryesuesit të Kuvendit ku prezent ishin shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit me të cilët jam konsultuar dhe nga të cilët kam kërkuar edhe këshillën dhe ndihmën e tyre sa i përket kësaj çështjeje. Personalisht mua si Kryetar i Komunës apo institucioneve komunale iu bie më mirë që ajo masë drusore të shitet përmes një shpalljeje publike, dhe me mjetet nga shitja e druve sigurisht se do të mund të bënim ndonjë investim apo diçka tjetër, mirëpo duke pasur parasysh edhe përvojën e viteve të kaluara që, pa saktësi po e them, se një metër dru është dashur të shesim rreth 18-20 € kurse është dashur të blejmë rreth 30-40 € po nga ata të cilëve iu është shitur ajo masë drusore, kështu që mua më është dukur jo normale ta publikojmë shpalljen për shitje të

asaj mase drusore sepse viteve të kaluara kemi publikuar nga 2-3 herë duke tentuar ta ngritim çmimin e shitjes, mirëpo nuk kanë ardhur çmime më të favorshme. Mua nuk më pengon fare nëse e shpallim ofertën për shitjen e asaj mase drusore, por jam i bindur se çmimi i blerjes së tyre do të jetë shumë i lirë, kurse neve do të na duhet të blejmë dru për raste sociale apo për institucione tjera me një çmim dy fish më të lartë, kështu që kam dashur të kem një rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, pse jo edhe nga ky Kuvend nëse ju dëshironi, ku pastaj unë me vendim të shpërndaj një sasi të druve për raste të rënda sociale të cilët çdo ditë kërkojnë dru për ngrohje dhe pjesën tjetër të druve për disa institucione tjera si, për disa shkolla, për shtëpi të shëndetit, dhe aty ku ka nevojë, pra ky është qëllimi, dhe për mua nuk paraqet pengesë asnjëra variant, qoftë përmes shitjes në bazë të procedurave të prokurimit apo të shpërndarjes, mirëpo do të ishte mirë që të merret parasysh se një numër i madh i familjeve të cilat jetojnë në kufi të ekzistencës dhe nuk kanë as dru për ngrohje çdo ditë kërkojnë ndihmë në këtë aspekt.

Sa i përket propozimit që u ngrit rreth një pike të veçantë, përkatësisht rreth rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, unë personalisht do të jap mendimin tim, duke u bazuar në përvojën që kam, asnjëherë nuk është praktikuar që rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të përfshihen si pikë e veçantë e rendit të ditës sepse nuk ka asnjë kuptim që në fillim të mbledhjes të nxjerrën rekomandimet, por rekomandimet shkojnë sipas pikave të rendit të ditës përkatësisht me hapjen e debatit për çështjen përkatëse, ngase ka pika të rendit të ditës për të cilat nuk kërkohet rekomandim i Komitetit, ndërsa ka çështje për të cilat kërkohet rekomandimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, ku në fillim duhet të prezantohet rekomandimi i KPF-së apo para votimit, e pastaj vendimi i Kuvendit merret pavarësisht rekomandimeve.

z.Haki Rudari, theksoi, sa i përket asaj që Kryetari i Komunës e theksoi rreth shpërndarjes së druve, unë në mbledhjen e KPF-së e kam propozuar që këtë çështje ta procedojmë dhe rekomandojmë në Kuvendin e Komunës dhe që të formohet një komision nga përbërja e Kuvendit për shpërndarjen e atyre druve, kjo ka qenë edhe në takimin me shefat e Grupeve të këshilltarëve, unë në parim e kam përkrahur por kurrësi nuk jam që të shkelet Rregullorja. Sa i përket çështjes rreth rekomandimeve unë kam hasur në praktika të tilla, shembull, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur dje pikën e dytë e ka pasur, rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa, sepse këshilltarët e Kuvendit duhet të njoftohen në lidhje me Komitetin për arsye se në KPF jemi 10 anëtarë kurse në Kuvend jemi 35 këshilltarë, andaj unë mendoj se duhet të jetë si pikë, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, sepse do të mund të njoftoheshin të gjithë këshilltarët të cilët nuk janë të përfaqësuar në KPF.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se Kryetari i Komunës shumë mirë i dha sqarimet, është e vërtetë se në zyrën time kanë qenë të gjithë shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit dhe të gjithë e kanë përkrahur që të merret një rekomandim në Komitetit për Politikë dhe Financa rreth shpërndarjes së druve, kështu që në lidhje me këtë çështje unë nuk shoh kurrfarë problemi, andaj më mbetet të hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se me 29 vota për 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 25 nëntor 2015

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të jap fjalën këshilltarëve, unë kam vërejtur një gabim i cili mendoj se është gabim teknik gjatë shtypjes, përkatësisht në faqen 3 të Ekstraktit ku thuhet *“verifikimi i mandatit dhe dhënia e betimit të dy këshilltarëve të Kuvendit”* kurse duhet të jetë *“verifikimi i mandatit dhe dhënia e betimit të këshilltarit të Kuvendit”*, andaj sugjeroj të përmirësohet ky gabim.

Pas votimi u konstatua se duke përfshirë sugjerimin për korrigjim të gabimit të sipërpërmendur nga Kryesuesi i Kuvendit, njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit.

3. Propozimi i vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës si monument i natyrës:

- Trungu i shparchit (*Quercus frainetto*) - Dyz
- Trungjet e dushkut (*Quercus sp.*) – Llapashticë e Epërme
- Trungu i dushkut (*Quercus sp.*) – Llapashticë e Epërme
- Vrella dhe trugu i ahut (*Fagus sp.*) – Dobratin
- Trugu i plepit (*Populus tremula*) – Murgullë
- Trugu i plepit (*Populus tremula*) – Gërdoc
- Trugu i plepit (*Populus tremula*) – Orllan

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, duke paraqitur fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë përkatësisht Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës, ka arritur një shkresë në të cilën rekomandohet që Komuna e Podujevës të vë në mbrojtje të vlerës së natyrës si monumente të natyrës shtatë objekte të natyrës dhe për të cilat Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozon miratimin e vendimeve përkatëse.

Vlen të ceket se gjatë viteve 2014 dhe 2015 zyrtarët e Institutit të Kosovës për Mbrojtje të Natyrës së bashku me zyrtarët përkatës të Komunës së Podujevës kanë evidentuar objektet përkatëse të trashëgimisë natyrore, andaj kjo ishte në pika të shkurta dhe nëse ndokush nga këshilltarët e Kuvendit ka ndonjë paqartësi lirshëm mund të diskutojmë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne edhe në mbledhjen e KPF-së e kemi shqyrtuar këtë çështje dhe njëzëri i kemi rekomanduar për miratim dhe mendoj se është interes i qytetarëve të Komunës që t'i kemi në mbrojtje këto objekte të trashëgimisë natyrore të cilat janë propozuar nga organi kompetent i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, dhe atë: Trugu i shparchit (*Quercus frainetto*) në fshatin Dyz, Trungjet e dushkut (*Quercus sp.*) në fshatin Llapashticë e Epërme, Trugu i dushkut (*Quercus sp.*) në fshatin Llapashticë e Epërme, Vrella dhe trugu i ahut (*Fagus sp.*) në fshatin Dobratin, Trugu i plepit (*Populus tremula*) në fshatin Murgullë, Trugu i plepit (*Populus tremula*) në fshatin Gërdoc dhe Trugu i plepit (*Populus tremula*) në fshatin Orllan. Vlen të ceket se për të gjitha këto objekte janë dërguar edhe elaboratet përkatëse të cilat u janë dërguar të gjithë këshilltarëve të Kuvendit.

z.Haki Rudari, theksoi, këto objekte natyrore me karakter botanik dhe biologjik do të thoja shkencor, gjeografik etj, janë të mbrojtura me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit respektivisht Instituti për Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës e ka përsipër mbrojtjen e tyre, mirëpo një çështje dua të ngris për sqarim nga Drejtoria përkatëse për arsye se ka edhe prona private, rasti konkret Tahir Ali Islamit në sipërfaqe prej 81.19 ari e regjistruar si arë klasa e VI në pronësi private, pra dua sqarim se si është e rregulluar kjo çështje kur kemi parasysh se prona është private kurse ne marrim në mbrojtje atë pronë.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës i përkrahim propozim vendimet përkatëse për vënien në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë natyrore si monumente të natyrës.

z.Flakron Gashi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit Partia Demokratike e Kosovës në parim mbështesim propozim vendimet për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë natyrore, dhe unë mendoj se jo vetëm që mbështesim por kjo çështje është në interes të Komunës në veçanti por edhe në interes të regjionit në përgjithësi që të kemi të ashtuquajturat monumente të natyrës.

Çështja e cila mua më bënë të theksoj është që Komuna duhet të punoj më përsëafërmi me ata qytetarë ku këto monumente janë në pronësi private, dhe këto vendime domosdoshmërisht nxjerrin edhe disa kufizime në shfrytëzimin e pronave përkatëse, ndërsa çështja tjetër që vlen të potencohet është se Komuna dhe organet qeverisëse në vitin e kaluar kanë pasur si projekt nxjerrjen e një strategjie për promovimin e zonave turistike, gjë të cilën nuk kanë arritur ta bëjnë, dhe nëse eventualisht Komuna arrin të nxjerrë vitin e ardhëm një strategji të tillë, këto monumente të natyrës duhet t'i inkorporoj në atë strategji për promovimin e zhvillimit dhe promovim të zonave turistike.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa unë jam i informuar, edhe nëse objektet e trashëgimisë natyrore gjenden në pronë private ato gjithsesi duhet që me vendim të merren në mbrojtje, dhe kjo çështje është e rregulluar me ligj.

Nëse nuk ka diskutues tjerë unë i hedh në votim, në pako, propozimet e vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës si monument i natyrës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan në pako propozimet e vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës si monument i natyrës, përkatësisht:

- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës trungu i shpardhit (quercus frainetto) në Dyz të Podujevës si monument i natyrës*
- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës trungjet e dushkut (quercus sp.) në Llapashticë të Epërme të Podujevës si monument i natyrës*
- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës trungu i dushkut (quercus sp.) në Llapashticë të Epërme të Podujevës si monument i natyrës*
- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës vrella dhe trungu i ahut (fagus sp.) në Dobratin të Podujevës si monument i natyrës*
- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës trungu i plepit (populus tremula) në Murgull të Podujevës*
- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës trungu i plepit (populus tremula) në Gërdofc të Podujevës si monument i natyrës*
- *Vendimi për mbrojtjen e vlerës së natyrës trungu i plepit (populus tremula) në Orllan të Podujevës si monument i natyrës*

4. Draft Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në Komunën e Podujevës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht se e keni lexuar dhe analizuar draft Planin Lokal të Veprimit për Riintegrim në Komunën e Podujevës, jemi të obliguar në bazë të legjislacionit në fuqi të hartojmë dhe miratojmë këtë Plan, mirëpo nëse dëshironi prezent këtu është edhe zyrtari për Integritet Evropian i cili mund të jap një fjalë hyrëse rreth këtij dokumenti.

z.Ylber Salihu, Zyrtar për Integritet Evropian në Komunën e Podujevës, fillimisht përshëndeti të pranishmit, në fjalën hyrëse, theksoi, në bazë të një shkresë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme bazuar në kompetencat dhe mandatin ligjor për mbikëqyrje të organeve komunale si dhe detyrimeve komunale nga strategjia dhe plani i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministri të cilat kanë identifikuar obligimet e Komunave në fushën e Integriteteve Evropiane, Komuna e Podujevës ka e obliguar ta themeloj grupit punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Riintegrim, grup i cili është formuar në këtë përbërje:

- z.Nexhmi Rudari,...Nënkryetar i Komunës,
- z.Agron Hyseni,.....drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- z.Avni Maloku,.....drejtor i Drejtorisë së Arsimit,
- z.Liman Zeqiri,.....shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe unë
- z.Ylber Salihu,.....zyrtar për Integritet Evropian.

Draft i planit u është dërguar të gjitha komunave, por detyrë e jona si grup ka qenë përshtatja me specifikat e Komunës së Podujevës, plan i cili është përbërë nga këto objektiva, fuqizimi i kapaciteteve komunale për riintegrim, fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në nivel horizontal dhe vertikal, sigurimi i shërbimeve të garantuara për politikën e riintegritetit, vetëdijesimi publik dhe mobilizimi social, funksionalizimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit. Draft i këtij Plani është hartuar në bazë të Strategjisë Nacionale për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Rregullores nr.08/2015 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegritetit, Udhëzuesit për ndihmë dhe mbështetje të personave të riatdhesuar për riintegrim të qëndrueshëm si dhe doracakut për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në shoqërinë kosovare.

z.Haki Rudari, theksoi, falënderoj parafolësin për sqarimet, ne e kemi analizuar këtë material dhe realisht objektivat janë shumë të mira në letër, por pyetja është si do të implementohen në terren. Komuna e Podujevës është një ndër Komunat më të prekura si pasojë e emigrimit të popullatës, andaj shtroj pyetje Ekzekutivit të Komunës se a janë vizituar ndonjëherë ato familje dhe cilat janë veprimet e ndërmarra nga ana e qeverisë komunale, për arsye se kemi kthim të riatdhesuar dhe këtë e them nga përvoja ime si punonjësi i arsimit ku ka shumë nxënës të cilët janë kthyer dhe shpesh na paraqitet problemi për t'i integruar në klasë të ndryshme. Në këtë draft thuhet, caktimi i një personi kontaktues për riintegrim i caktuar nga secila Drejtori apo Zyre, pyetja është, a është fjala nga personeli i cili është duke punuar apo ka të bëjë me personel tjetër që duhet t'i marrin apo t'i caktojnë Drejtoritë e Komunës. Pastaj çështje tjetër është, referimi i personave të

riatdhesuar për regjistrim në zyrat komunale, shtrohet pyetja, cilat janë veprimet të cilat i ka marrë qeveria komunale që familjet e kthyer të ndihmohen në formë të ndryshme, qoftë në aspektin social, ekonomik etj. për arsye se në këtë draft plan parashihet edhe banimi i qëndrueshëm, andaj konsideroj se nuk është mirë që këto çështje të duken vetëm në letër por është mirë që në praktikë të implementohen sa më mirë sepse është interes i qytetarëve të cilët kthehen.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përgëzojmë Zyrën për Integritet Evropian për punën bërë dhe të cilën është duke e bërë në vazhdimësi, andaj ne e përkrahim Draft Planin për riintegrimin e personave të riadhesuar, dhe konsiderojmë se është plan i mirë dhe konkret i cili iu ndihmon të gjithë atyre personave të kthyer apo të riadhesuar.

z.Flakron Gashi, theksoi, unë nuk mendoj se Zyra për Integritet Evropian ka bërë një punë të mirë ashtu siç e tha z.Fidan Rekaliu, sikur të bënte një gjë të tillë sigurisht se do të shërbente si masë preventive ngase Komuna e Podujevës ka qenë njëra ndër Komunitet me numrin më të madh të emigrimit ilegal. Unë shtroj pyetje për zyrtarin përkatës ose për ndonjërin prej drejtorëve, a do të ketë implikime buxhetore implementimi i këtij Plani dhe cila do të jetë kostoja financiare me të cilën ngarkohet Komuna.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, falënderoj parafolësit për sqarimet, pyetjet dhe çështjet e ngritura. Nëse ka të tjerë për diskutim unë e hedh në votim këtë draft.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua drafti i Planit Lokal për riintegrimin e personave të riadhesuar në Komunën e Podujevës

5. Propozimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju njoftoj se unë në cilësinë Kryesuesit të Kuvendit në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës ju kam drejtuar me shkrim gjithë drejtorëve të Drejtorive ku njëkohësisht e kam njoftuar edhe Kryetarin e Komunës për të gjitha pikat të cilat duhet të shqyrtohen në vitin e ardhshëm në bazë të ligjeve përkatëse, por kam kërkuar nga drejtorët e Drejtorive edhe pika tjera të cilat ata i parashohin si të nevojshme të cilët janë përgjigjur dhe kanë dërguar propozimet e tyre, pastaj për të gjitha pikat janë njoftuar edhe shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit të cilët njëkohësisht janë ftuar në një takim të përbashkët në Zyrën time ku kemi diskutuar rreth kësaj çështjeje. Në atë takim kanë rrjedhur propozime të ndryshme nga shefat e Grupeve dhe pothuajse të gjitha ato janë përfshirë në këtë propozim plan, mandej kemi pasur disa propozime edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të cilat po ashtu janë përfshirë në këtë propozim plan dhe u janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Vlen të ceket se në propozim vendim është edhe neni 2 sipas të cilit pavarësisht pikave të përfshira në propozim planin përkatës Kuvendi mund të përfshijë edhe pika tjera sipas nevojave të paraqitura. Po ashtu sigurisht keni vërejtur se për vitin 2016 janë paraparë rreth 50% më shumë pika se në vitin 2015, dhe besoj se me një punë të përbashkët do të realizojmë këtë propozim Plan.

z.Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë se nga Kryesuesi i Kuvendit jemi ftuar shëfat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit më 15.12.2015 gjë të cilën ne e përkrahim ngase në të kaluarën plani është bërë në mënyrë të njëanshme, andaj edhe e përshëndesim këtë. Unë në emër të Grupit kam paraqitur katër propozime. Do të ngris çështjen që ka të bëjë me Rregulloren komunale të miratuar më 29 prill 2010 ku në nenin 88.1 thuhet, *pas miratimit të Programit të punës, Kuvendi e përcakton kalendarin e mbajtjes së mbledhjeve për vitin përkatës fiskal*, do të thotë përcaktohet kalendar i mbajtjes së mbledhjeve, ndërsa neni 88.2 thotë, *datat e caktuara për mbajtjen e mbledhjeve mund të lëvizin më së shumti 7 (shtatë) ditë pune*, gjë e cila në këtë plan mungon, andaj mendoj se do të ishte mirë t'i përmbahemi kësaj Rregulloreje në të cilën ceken shumë qartë çështjet e cekura më lart, prandaj ky është edhe si propozim i imi që përveç pikave të parapara ta kemi edhe kalendarin e mbajtjeve të mbledhjeve. Gjithashtu është e vërtetë se kam propozuar në mbledhjen e KPF-së dhe është marrë parasysh, por tani meqë prezent këtu është edhe Kryetari i Komunës kam edhe një propozim dhe atë, ta kemi një raport pune nga bordi apo këshilli i drejtorëve për vitin 2015, ngase mendoj se është e nevojshme për ne këshilltarët e Kuvendit të kemi një raport të tillë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjen e potencuar nga parafolësi ju njoftoj se propozimi i këtij plani është përgatitur pa asnjë vërejtje nga ana e shëfave të Grupeve të këshilltarëve dhe gjitha propozimet e tyre janë përfshirë në këtë propozim, kurse lidhur me propozimin e parafolësit rreth caktimit të datave, mendoj se është e pamundshme për arsye se ka disa procedura rreth përgatitjes së materialeve, afateve ligjore e gjëra tjera. Sa i përket çështjes tjetër, bazuar në ligj, Kryetari i Komunës nuk ka bord të drejtorëve mirëpo Kryetari përmes drejtorëve ka paraqitur raportet e punës kështu që nuk mendoj se ka diçka të pa qartë sa i përket këtyre çështjeve.

z.Flakron Gashi, theksoi, në parim ne e mbështesim këtë propozim plan dhe shohim se është më voluminoz se plani i punës për 2015, po ashtu unë shoh dy çështje të cilat kanë qenë në plan por që nuk kanë mundur të realizohen në 2015, draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal, çështje të cilat shpresoj të përfundojnë në vitin 2016, por sipas mënyrës dhe qasjes së punës së deritanishme mendoj se vështirë se do të realizohen, gjithashtu do të ishte mirë që pjesë e këtij plani të ishte edhe plani dinamik i prokurimit për vitin 2016 si dhe një raport i auditorit të brendshëm sa i përket zyrës së prokurimit dhe njësisë së auditorit të brendshëm.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, sa i përket Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal sigurisht se keni vërejtur se kjo çështje është e paraparë në muajin janar 2016 për të cilën jam i njoftuar se do të jetë e gatshme po në atë muaj, gjithashtu edhe Planit Zhvillimorë Komunal është i gatshëm më së largu deri në muajin shkurt. Sa i përket planit të prokurimit, jam i njoftuar se është dorëzuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik–KRPP dhe kjo çështje varet krejt nga projektet e miratuara nga ky Kuvend ku drejtorët planifikojnë fillimin e procedurave, pra plani ekziston dhe mund të gjendet në fagen e KRPP-së dhe kush do që është i interesuar mund ta merr atë, por mund ta merr edhe në zyrën e prokurimit në Komunë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, z.Flakron Gashi në fakt kërkoj që në kuadër të këtij propozim plani të përfshihen edhe dy çështjet të cilat ndërlidhen direkt me zyrën e prokurimit. Dakord që janë në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik por kërkoj që edhe ne si Kuvend i Komunës të kemi ato dy çështje në planifikimet tona me qëllim që të jemi të informuar rreth planifikimit të zyrës së prokurimit dhe me një raport të auditorit të

brendshëm rreth funksionimit dhe realizimit të këtij plani, prandaj lidhur me këto dy çështje mendoj se është edhe obligim i Komunës por edhe që ka qenë kërkesë e disahershme edhe përkundër që Kryetari i Komunës e pati thënë një herë se, nuk e keni kërkuar një gjë të tillë se përndryshe çdo herë jemi të gatshëm që këto gjëra t'i sjellim në Kuvend.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket planit të prokurimit konsideroj se nuk ka asgjë që duhet të fshehet, andaj kur dëshironi mund ta shihni atë.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, propozim plani i punës së Kuvendit për vitin 2016 është hartuar bashkërisht dhe të gjithë jemi pajtuar sa i përket pikave të parapara dhe askush nuk ka pasur asgjë kundër ndonjë propozimi të dhënë nga shefat e Grupeve të këshilltarëve ku të gjitha janë përfshirë në këtë dokument. Jemi në dijeni dhe është e rëndësishme të ceket se ky propozim plan nuk është përfundimtar ngase neni 2 e potencon shumë qartë se varësisht prej nevojave dhe kërkesave të këshilltarëve të Kuvendit apo të Ekzekutivit të Komunës, gjatë punës së Kuvendit mund të futen edhe pika tjera në rend dite, do të thotë se nuk është plan përfundimtarë dhe mund të futen edhe pika tjera në vitin 2016 varësisht prej nevojave dhe kërkesave, por ky propozim për të cilin jemi duke debatuar është një bazë se si do të funksionoj Kuvendi në vitin 2016.

z.Agim Velu, Kryetar i Komunës, theksoi, sa unë jam i informuar, planifikimi i prokurimit është dorëzuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik – KRPP, dhe atë mund ta merr nga web faqja zyrtare e KRPP-së secili që është i interesuar, ose në Zyrën e prokurimit në Komunën e Podujevës, mirëpo unë jam në dijeni se është rregull që asnjë procedurë nuk mund të zhvillohet nëse Plani i prokurimit nuk dorëzohet me kohë në KRPP, në këtë kontekst Komuna e Podujevës ka vite me radhë që nuk ka kurrfarë problemesh sa i përket Planit të prokurimit, dorëzimit me kohë në KRPP dhe zhvillimit të procedurave konform rregullave në fuqi.

z.Flakron Gashi, theksoi, i nderuari Kryetar është mirë njëherë me menduar se a mendojnë edhe këshilltarët e Kuvendit se a ka problem Komuna e Podujevës me prokurimit apo jo, e jo sikurse që mendoni ju. Unë mendoj se ka problem sepse Zyrës së prokurimit asnjëherë nuk i është bërë një auditim dhe gjithashtu do të ishte mirë që nëse atë planifikim të prokurimit e posedon KRPP-ja, ai është institucion në vete kurse ne si Komunë jemi institucion në vete, dhe mos tentoni t'i shkelni obligimet të cilat i keni karshi këtij Kuvendi Komunal, andaj nuk mendoj se ka diçka të keqe që të kemi edhe ne atë plan dinamik të prokurimit sepse jeni në dijeni shumë mirë se janë duke u realizuar edhe projekte të pa parapara në listën e projekteve prioritare të miratuara në këtë Kuvend.

z.Agim Velu, Kryetar i Komunës, theksoi, unë më shumë i besoj Auditorit të Jashtëm se sa auditimit të brendshëm, dhe për këtë jam i prirur, ngase auditimin e brendshëm e bëjmë vetë. Raportet e Auditorit të Jashtëm, në vitet e fundit, për Komunën e Podujevës janë raporte prej më të mirave në bazë të të cilave Komunës së Podujevës i është hapur rrugë të hyjë në raporte apo marrëdhënie jo vetëm brenda Republikës së Kosovës por edhe jashtë saj, pra janë raporte të cilat nuk evidentojnë asnjë shkelje materiale, mirëpo janë disa vërejtje dhe disa theksime të cilat vazhdimisht nga viti në vit jemi duke i eliminuar, por e rëndësishme është se shkelje materiale nuk ka. Po e përsërisë se jam i prirur të besoj në vlerësimet e Auditorit të Jashtëm sepse kur e marrë një raport të Auditorit të Jashtëm për Komunën e Podujevës sipas të cilit janë zhvilluar 200-300 procedura të prokurimit dhe nuk është anuluar asnjë procedurë por edhe nuk ka pas ankesa, kjo është dëshmi por edhe jam i bindur se është bërë një punë e mirë, mirëpo

pavarësisht kësaj, në këtë aspekt, vazhdimisht do të kërkoj të kemi kujdes në zbatimin e ligjshmërisë në mënyrë që të mos ketë ndonjë shkelje eventuale. Kështu që Raportet e Auditorit të Jashtëm janë transparente dhe të publikuara në web faqe zyrtare të cilat mund t'i shkarkoj secili që është i interesuar, nëse dëshironi ne mund të presim edhe raportin për vitin 2015 i cili publikohet në vitin e ardhshëm, pastaj ta hapim si çështje dhe të debatojmë. Përndryshe Raportet e Auditorit të Jashtëm shqyrtohen edhe në këtë Kuvend.

Sa i përket realizimit të projekteve që nuk kanë qenë të planifikuara, ne do të realizojmë projekte të tilla edhe gjatë vitit 2016 në qoftë se na jepet mundësia, e them këtë ngase duke iu falënderuar konkurrencës dhe zhvillimit të procedurave ne shpeshherë kontraktojmë punë me çmime më të vogla se sa që janë parashikuar, e me këtë krijohet tepriçë e mjeteve, dhe pastaj me rishikim të buxhetit ju si Kuvend keni vendosë dhe keni bërë ndryshime sipas propozimeve të Ekzekutivit. Madje unë kam pasur ndërmend që të gjitha kompanitë të cilat kanë punuar këtë vit në Komunën e Podujevës t'i ftoj në një drekë ose darkë sepse në bazë të konkurrencës së tyre mes vete, por edhe në saje të zhvillimit të procedurave konform standardeve dhe ligjeve përkatëse, kemi arritur të realizojmë projekte më tepër se sa që kemi planifikuar, duke iu falënderuar atyre kompanive të cilat kanë punuar me çmime të ulëta.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, zotëri Kryetar, nuk ishte fjala as për besime individuale e as për besime institucionale sepse besueshmëria e auditorit të brendshëm dhe Auditorit të Jashtëm duhet të jetë e njëjtë ngase edhe fushveprimtaria e auditorit të brendshëm është e obligueshme dhe është ligjore, prandaj ne nuk ngritëm asnjë dilemë ose shqetësim në raportin e auditorit i cili nuk ka qenë asnjëherë bash ashtu i mirë për Komunën e Podujevës sepse çdoherë janë konstatuar lëshime dhe dobësi, mirëpo ishte një kërkesë e ligjshme, ngase jemi duke biseduar për çështje të cilat janë të rregulluara me ligj. Çështja tjetër, neve na vie mirë që Komuna e Podujevës ka arritur të krijoj raporte edhe me Komunat jashtë vendit sepse edhe kjo është kategori ligjore dhe e drejtë ligjore e Komunave dhe në këtë aspekt dëshirojmë që Komuna jonë të ketë sa më shumë marrëdhënie me Komuna jashtë vendit të cilat do të ishin në funksion të zhvillimit ekonomik të Komunës.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, dëshiroj të saktësoj se fjala nuk ishte për marrëdhëniet e Komunës së Podujevës me Komunat tjera sepse ato janë çështje të bashkëpunimit dhe partneriteteve të ndryshme, por fjala ishte që raportet e auditimeve të jashtme Komunës së Podujevës i kanë mundësuar të hyjë në raporte kreditimi me huamarrje me kamata shumë të ulëta, dhe krejt kjo është mundësuar falë punës së mirë të Zyrës së prokurimit, dhe raporteve të mira të Auditorit të Jashtëm të cilat kanë qenë raporte të pakualifikuara me theksime të çështjeve.

znj.Kumrie Hoti, theksoi, dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam kërkuar që në planin e punës së Kuvendit për vitin 2016 të përfshihet edhe një informatë lidhur me sektorin e shëndetësisë, kërkesë e cila është mbështetur dhe është rekomanduar në Kuvend, dhe më vie mirë për këtë, por kërkoj që kjo çështje të përfshihet para rishikimit të buxhetit për vitin 2016 për arsye që të jemi në dijeni për nevojat dhe prioritetet e sektorit të shëndetësisë në mënyrë që të na mundësohet të riallokojmë mjete buxhetore në këtë sektorë, pra informata është paraparë në muajin korrik, kurse unë kam kërkuar dhe kërkoj të përfshihet para rishikimit të buxhetit për vitin 2016.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket kërkesës së parafolës, nuk konsideroj se ka ndonjë problem rreth caktimit të muajit se kur do të prezantohet informata e cekur, andaj e konsideroj si të pranueshme dhe do të rregullohet kjo çështje. Nëse nuk ka të interesuar të tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim propozimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2016 duke përfshirë edhe rekomandimet e KPF-së.

Pas votimit konstatua se njëzëri u miratua propozim Planit i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2016, duke përfshirë edhe propozimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

6. Të Ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-107557
Podujevë,
30 dhjetor 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**